

**2 KKP e re në degën e pastrimit Paga më të larta në Zvicrën gjermane**

**3 Intervistë me Mauro Moretto Trajnimi «Progresso» ideal për ngritjen profesionale**

**4 Risitë e sigurimeve shoqërore për vitin 2022 Infomacione mbi ndryshimet e rëndësishme**

Nr. 1 | shkurt 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Jo reduktimit të pensioneve (AHV/AVS)

## Duart larg nga pensionet tona!



Të angazhohemi bashkë për të ndaluar valën borgjeze të sulmeve ndaj pensioneve tonal

Me 17 dhjetor 2021 parlamenti ka miratuar reformën AHV/AVS 21. Kundër këtij propozim ligji do të mbahet referendum. Afati i referendimit kalon me 7 prill 2022. Reforma AHV/AVS 21 domethënë reduktim pensionesh! Fillimisht për gratë – atyre do tu duhet që të punojnë një vit më gjatë, pa përfituar asgjë nga kjo. Nëse përllongaritet kjo, atëherë ato do marrin 1200 franga më pak në vit! Ne mbrohemi kundër këtij sulmi. Unia mbështet referendumin kundër parashtrësës reduktuese AHV/AVS 21.

Emine Sariaslan

### Më pak për jetesë

E djathta, partitë e mesit dhe shoqata e ndërmarrësve duan që përmes reformës të rrisin moshën e pensionit për gratë. Parlamenti federal ka miratuar propozimin për ndryshim in e ligjit me 125 kundër 67 votave dhe një abstenimi. Edhe komisioni për siguri sociale i senatit (SGK-S/CSSS) vetëm se ka miratuar këtë reformë. Shumica e politikanëve, të cilët janë anëtarë të këtij komisioni, janë të mendimit, që gratë duhet të punojnë një vit më gjatë. Ata duan që pensionimi i grave të rritet nga 64 në 65 vjeç.

### Çfarë domethënie ka për gratë reforma AHV/AVS 21

Rritja e moshës së pensionimit në AHV/AVS 21 u kushton grave edhe 7 miliardë franga më shumë. Në mesatare pra gratë marrin 1200 franga më pak. Gratë në Zvicër marrin së paku për 1/3 më pak pension sesa burrat. Diferenca e madhe e pensioneve gjinore aktuale tregon ndarjen e pabarabartë të mundësive të punësimit në të kaluarën. Pasi gratë shpesh ndërpresin veprimtarinë e punësimit dhe puno-

jnë më shumë pjesërisht, që të dyja këto kryesisht shkak i jetës familjare, për të marrë përsipër punët familjare dhe ato të shtëpisë. Edhe dallimi në paga kontribuon në dallimet gjinore tek përfitimet nga pensionet. Puna e shumë grave, për këtë shkak qon në pensione të ulëta e pa dinjitet. Një e treta e grave në pleqëri duhet të jetoj ekskluzivisht nga pensioni i AHV/AVS dhe një nga gjashtë gra mbi moshën 65 vjeç jeton në varfëri.

### Edhe burrat janë të prekur

Mirëpo edhe pensionet e burrave janë të prekura. Pasi AHVAVS /21 parqet tek fillimin e një sulmi masiv ndaj pensioneve të pleqërisë. Si hap i ardhshëm kërcënon vjedhja e pensioneve në shtyllën e 2-të me përkeqësime për të gjithë të siguruarit. Dhe një nismë e pakuptimtë e liberalëve të rinj duan që të gjithë të punojnë deri në moshën 67 vjeç!

### Të rriten pensionet, jo mosha e pensionimit

Është koha që në Zvicër më në fund të zhvillohet një diskutim mbi problemeve e vërteta të pensioneve: që shumë njerëz nuk mund të jetojnë

më nga pensionet e tyre. Ne duhet që të forcojmë AHV/AVS-in në vend se ta dobësojmë. Ne duhet ti rrisim pensionet, jo moshën e pensionimit.

### Shtylla e 2-të: Për gratë vetëm një shtesë e pakët

Sigurimi pensional profesional shumë grave u shërben – dhe veçanërisht asaj gjenerate të grave, që pensionohen në vitet e ardhshme – vetëm si shtesë e dobët. Megjithëse edhe më tej gati një e treta e grave nuk merre fare pension nga shtylla e 2-të. Edhe nëse paguhet një pension nga arka pensionale, pensioni mesatar i grave nga arka e pensioneve është vetëm përgjysmë nga ajo e burrave. Gjysma e grave, të cilat janë pensionuar në vitin 2018, nga arka pensionale merr një pension nën 1165 franga në muaj. Në sektorët tipik të grave pensionet e zakonshme nga arka pensionale janë mes 500 dhe 800 frangave në muaj; këto nuk mjaftojnë për të jetuar.

### Diskriminim vazhdon më tej edhe në moshën e pensionimit

Andaj është një realitet i pikëlluar, fakti që gati 11% e të gjitha grave duhet që qysh me kalimin në pension të apliko-

jnë për të ardhura suplementare, për të mundur që të përballojnë harxhimet jetësore. Më 2019 gjithsejtë 140 000 gra kanë marrë të ardhura suplementare – tek burrat janë gjysma e këtij numri. Veçanërisht të prekura janë gratë e ndara dhe të vejat.

### Të punohet më gjatë

AHV/AVS 21 është vetëm fillimi: e djathta borgjeze qysh tani planifikon moshën e pensionit me 67 vjeç për të gjithë dhe ulje të mëtejme të pensioneve nga arka e pensioneve. Andaj është me rëndësi që ne qysh tani ta luftojmë reformën e AHV/AVS. Me 4 janar 2022 një bashkim i sindikatave, partive të majta dhe organizatave të grave kanë nisur referendumin kundër propozim ligjit në fjalë. Ne dot ë grumbullojmë dhe dorëzojmë 50 000 nënshkrimet e nevojshme. Me këtë fillon lufta jonë kundër reformës së AHV/AVS 21. Të gjithë/a zviceran:et, migrant:et e natyralizuar:a mund ta nënshkruajnë referendumin: tek Unia apo përmes internetit:

[www.frauenrenten.ch/referendum-unterschreiben/?src=unia](http://www.frauenrenten.ch/referendum-unterschreiben/?src=unia)

## Editorial



### 2022-ta dhe sfidat, të cilat (edhe më tej) kanë të bëjnë me ne

Ky vit si edhe deri më tani do të karakterizohet me sfidat sistemore: Pandemia e COVID-it, kriza klimatike, rritja e së djathtës populiste, rritja e mëtejme e hendekut mes të varfërve dhe të pasurve, diskutimet themelore rreth fakteve, përkeqësimi i statusit të dhjetëra mijëra njerëzve, pengesat burokratike dhe autoritare për një qasje korrekte politike e kulturore në shoqëri dhe diskriminimi ndaj grupeve të marginalizuara: gratë, njerëzit ndesh (interseksual), njerëzit me ngjyrë, migrant:et; janë vetëm disa nga ta.

Bazuar në gjendjen momentale (dhe gjithmonë ekzistuese) është e thjeshtë për të thënë, që kjo është thjeshtë kështu, s'kemi ç'të bëjmë dhe nuk duam të merremi me tema të tilla. Mirëpo gjithashtu, që njeriu ndihet i pafuqishëm, që njeriu si individ nuk mund ta luftojë farë kundër kësaj gjendjeje. Andaj janë të rëndësishme grupimet, shoqatat apo pra edhe sindikatat, sikur kjo e jona – këtu ne bashkojmë fuqinë tonë, këtu ne kemi bashkëlufëtaret dhe kështu ne ngremë zërin tonë. Bashkë, me solidarizim, me feminizëm, në aleancë!

Kohës time si praktikues në Unia, në sektorin politik të qendrës, ngadalë po i afrohet fundi. Por, për të parë se na sa fronte njerëz të ndryshëm angazhohen për një Zvicër korrekte, inklusive (gjithëpërfshirëse) dhe progresive, të jep ndjenjën e shpresës.

Uroj një vit tjetër bashkëpunimi dhe bashkimi të betejave të ndryshme!

Mirupafshim, dhe shihemi së shpejti!

Artan Islamaj

## News

## Ueb dosja e re «Sans-Papiers»

Dhjetëra mijëra njerëz jetojnë e punojnë pa leje qëndrimi në Zvicër. Ueb dosja jonë e re ofron përgjigje në pyetjet e rëndësishme rreth situatës së personave pa letra (Sans-Papiers). Unia mbështet edhe punëmarrësit pa leje qëndrimi dhe ofron informacione mbi të drejtat themelore përkita-zi me temat vijuese: Rregullimi i qëndrimit, shëndeti, puna, arsimimi dhe trajnimi, kurse gjuhësore dhe aktivitete sociale, banimi, policia dhe drejtësia, mbështetje në rast nevojë e emergjence, diskriminimi, të rreziqeve, të lajmërit tek autoritetet për migracion dhe adresave me dobi.

Ueb dosja është në dispozicion në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht. Pas pak kohësh do të jenë në rrejt online edhe versionet në shqip, spanjisht, portugalisht, serbisht/kroatisht/boshnjakisht, turqisht dhe anglisht.

## Gjykim i ri udhërrëfyes: shofer:et e Uber janë të punësuar, jo të pavarur

Enti i Sigurimeve Shoqërore (SVA) të Cyrihut për vitin 2014 kërkoi nga Uber kontribute të sigurimeve shoqërore plus kamata në lartësinë prej rreth 5,2 milion frangash. Gjyqi tek të gjitha 5 ankesat erdhi në përfundim, që Uber është një punëdhënës dhe për këtë shkak refuzoi ankesat e Uber. Sipas përlogaritjeve të Unia, mijëra të punësuarve të saj në Zvicër Uber për periudhën 2013–2021 u ka borxh disa qindra milion franga. Uber duhet më në fund të ndalojë procedurat e saja të shtrenjta juridike dhe të punësojë në mënyrë të rregullt punëmarrësit e vet!

Ky vendim ka ndikim sinjalizues për të gjitha ndërmarrjet, të cilat ndërmjetësojnë në mënyrë digjitale porosit e mandatet punëmarrësve të tyre. Ja pa shkas, në lidhje me platformë-ekonomike, flitet edhe për Uberzimin. Autoritetet të ndalojnë modelin ilegal të Uber dhe të kujdesen, që të gjithë punonjësit të paguhen e punësohen në mënyrë korrekte.



## Protestë kundër largimit të DPD-shoferëve në Tiçino

Parregullsitë në DPD ka kohë që janë të njohura: ditë të stërgjata të punës, orët e papaguara shtesë, mungesë e kompensimit të harxhimeve, stres i jashtëzakonshëm. Ka mbi një vit që shofer:et bashkë me sindikatën Unia mbrohen kundër kësaj gjendjeje. Në Tiçino DPD përpiqet të thyejë komitetin sindikalist të punonjësve: Pesë shofer janë shkarkuar në fillim të vitit, pasi që janë angazhuar për kushte më të mira pune. Unia kërkoi nga DPD, që të kthejë menjëherë në punë shoferët. Rreth 1000 persona kanë nënshkruar për këtë një peticion gjegjës, i cili është paraparë të dorëzohet në fund të janarit. Unia i është drejtuar shoqërisë frënge amë GeoPost, duke ia ka tërhequr vërejtjen mbi shkeljen e të drejtave sindikaliste nga ana e DPD në Zvicër.

## Jo edhe më shumë të diela pune!

Nisma parlamentare Schneberger është jashtë tryezës. Ajo kishte për qëllim që të punësuarit e të gjitha ndërmarrjeve shërbyese ti linte të punonin në 4 ditë e diele. Unia ka kundërshtuar që nga fillimi këtë nismë dhe përshëndet vendimin udhërrëfyes të komisionit. Tanimë duhet që kjo shenjë e qartë të merret seriozisht. Përpjekjeve aktuale, për mosrespektimin e ndalesës të punës së dielave, duhet dhënë fund. Unia gjithashtu angazhohet edhe në rrjetin Aleanca e së Dielës Unia kundër eliminimit të pushimit të dielave. Kjo Aleanca ishte gjithashtu kundër nismës Schneeberger.

## KKP-Pastrimi

## Paga më të larta minimale në Zvicrën gjermane

Nga 1 janari 2022 ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive e Punës (KKP) e re e pastrimit për Zvicrën gjermane. KKP e re përbënë rritje pagash dhe fuqizimin e zbatimit të marrëveshjes sa i përket përmirësimeve për punëmarrësit.

Artan Islamaj

KKP e re, në fuqi nga 1 janari 2022, vlen deri me 31 dhjetor 2025. Është negociuar nga sindikatat Unia, VPOD, Syna dhe shoqatën e punëdhënësve Allpura dhe vlen për të punësuarit në degën e pastrimit në Zvicrën gjermane. Kontrata e re është në përputhje me zhvillimin e vazhdueshëm të pagave në vitet e fundit. Mes kontratës së parë të përfunduar ë vitin 2014 dhe të asaj për vitin 2024 pagat e negociuara janë rritur për 35%. Nga viti 2024 nuk do të ketë më pagë ore nën 20 franga.

## Më shumë pagë falë trajnimit të mëtejshëm

Komisioni paritetit i degës së pastrimit në Zvicrën gjermane ofron për punëmarrësit e pakualifikuar të degës në fjalë një program të brendshëm trajnimi, përfundimi i suksesshëm i të cilit si rezultat ka të drejtën e rritjes së pagës minimale. Fjala është për një arsimim 80 orësh falas për të punësuar:et në degën e pastrimit, të cilët nuk kanë ndjekur arsimimin formal. Pas mbarimit të suksesshëm të këtij arsimimi të njohur ekziston e drejta e një shkalle më

## Informacione mbi KKP-në e re

Unia ka publikuar një fletëpalosje në shumë gjuhë mbi rregullat e rëndësishme të KKP për pastrim në Zvicrën gjermane. Kjo fletëpalosje si dhe informacionet tjera mbi KKP-në e re gjenden në sekretariatet e Unia. Teksti i plotë i KKP-së të re në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht, Informacione mbi trajnimin e arsimimin e mëtejshëm, pyetje e përgjigje mbi rregullat e ndryshme mund ti gjeni në ueb faqen e komisionit paritetit të degës së pastrimit: <https://www.pk-reinigung.ch>



Puna në degën e pastrimit në Zvicër duhet të vlerësohet dhe shpërblehet meritueshëm

të lartë të pagës (pastrim mirëmbajtjeje II, pastrim special II, pastrim automjeteve II) dhe në përputhje fiton më shumë. Pasi për ndjekjen e këtij kursi nevojitet njohja e mjaftueshme e gjermanishtes, partnerët kontraktues për të punësuarit e

degës së pastrimit organizojnë edhe kurse të gjermanishtes.

## Fuqizohet mbrojtja e pagave

Krahas rritjes së pagave është arritur dhe një përmirësim sa i përket zbatimit. Dumpingu në paga në degën e pastrimit është edhe më tej i përhapur. Me rritjen e kontributeve zbatuese për financim të kontrolleve, ndalimi i pagesës me para në dorë të pagave dhe përcaktimi i kategorive të punësimit KKP përbënë risi të rëndësishme për një zbatim me ndikim të plotë të marrëveshjes.

## Punëmarrësit duhet të mbrohen nga dumping-modeli i bizneseve

## Arbitrazhi në mosmarrëveshjen e punës tek Smood ka dështuar

Nga 29-30 tetor u zhvillua sesioni i grave i organizuar nga Aleanca F. Në sesionin e grave morën pjesë 246 gra me përvojë e preokupime të ndryshme. Ato megjithatë kanë të njëjtin qëllim: barazinë, trajtimin e barabartë, pa diskriminim.

Hilmi Gashi

Fakti, që ndërmarrja e kurir:eve Smood, qysh në kohën që gjatë procedurës ka shkarkuar nga puna punonjësit grevistë, paraqet lëndim të rregullave të procedurës. Unia dënon këtë sjellje dhe edhe më tej do të mbështesë plotësisht të prekurit sikur edhe të punësuar:et e Smood në përballjet e ardhshme. Tani fjalën e kanë edhe autoritetet: Ata duhet të kujdesen, që Smood të respektoj rregullat ekzistuese ligjore, dhe të ndalojë modelin e biznesit, që së fundi mbështetet në dumping pagash.

Edhe përkundër grevës 5 javore në shumë vendndodhje në Zvicrën perëndimore dhe një procedure të iniciuar të arbitrazhit në Kantonin e Gjenezës, nuk u arrit të gjendet një zgjidhje e konfliktit të punës tek shërbimi kurir. Andaj, sindikatat kërkojnë nga Smood, që të ftojë e pranojë Dhomen mbi Marrëdhëniet Kolektive të Punës (CRCT) si gjykatë arbitrazhi për pikat qendrore të mosmarrëveshjes.

## Punonjësit po luftojnë për dinjitetin e tyre

Unia pretë nga Smood që menjëherë të zbatojë së paku përmirësimin e kushteve minimale të punës, të cilat firma në javën e kaluar i ka premtuar. Kurir:et kërkojnë posaçërisht një plan më të mirë pune, dhënie fund të «kontratave të orëve zero» dhe pagesën e të gjitha orëve të shërbyera efektive përfshi edhe kohën e tanishme pritëse të papaguar, kompensimi i harxhimeve efektive për përdorimin e automjeteve private dhe telefonave mobil. Së fundi kërkojnë transparencë mbi bakshishet në të holla si dhe kilometrat e kaluara dhe orët e bëra.

## Shkarkimi i grevistëve

Gjatë procedurës së arbitrazhit Smood aty për aty shkarkoi tre delegatë sindikalistë, ndër ta edhe një anëtarë të përfaqësimit së personelit, që kishte marrë pjesë në bisedime. Kështu Smood



Unia mbështet kërkesat e drejta të kurir:eve karshi Smood

shkeli të drejtat sindikaliste. Punonjës tjerë pas përfundimit të grevës iu janë caktuar dukshëm më pakë porosi pune; me pasoja gjegjëse negative për të ardhurat e tyre. Unia kërkoi, që Smood të ndërpresë menjëherë të gjitha veprimet hakmarrëse dhe të anulojë shkarkimet nga puna.

## Një model dumpingu pagash

Modeli i biznesit i bazuar në dumping pagash nga Smood përqendron thellësisht pozitën e punonjësve. Unia dhe të prekurit kërkojnë nga autoritetet kantonale që të ndërhyjnë dhe të zbatojnë ligjet dhe rregullat ekzistuese tek Smood. Në të njëjtën kohë Unia do të ndërmarrë gjithçka që në të ardhmen të respektohen Kontrata aktuale Kolektive e Punës edhe tek Smood, veçanërisht KKP kombëtare. Kjo vlen, ashtu siç ka vërtetuar komisioni mbikëqyrës i saj, për kurir:et e Smood ashtu sikur edhe për kurir:et që janë të punësuar:a drejtpërdrejt nga restorantet.

## Sigurimi i invaliditetit IV/AI: Regjistrimi i ekspertizës vlerësuese

# Masa për më shumë transparencë

Për të përmirësuar ekspertizat vlerësuese mjekësore, nga ky vit do të bëhet regjistrimi i intervistave me ekspertët e IV/AI, të cilat do ti bashkëngjiten akteve.

Marilia Mendesi

### Përse bëhet ky rinovim?

Me rastin e sqarimeve në lidhje me përfitimet nga sigurimi i invaliditetit shpesh nevojitet një ekspertizë mjekësore. Gjithnjë më shpesh të prekurit ankohen se me rastin bisedës me ekspertë që bëjnë ekspertizës mjekësore, ankesat e tyre shëndetësore nuk regjistrohen siç duhet. Andaj tani kërkohet të ketë më shumë transparencë. Me këtë sigurimi i invaliditetit (IV/AI) dëshiron të përmbyllë ekspertizat në procedurë marrëveshjeje.

### Përse është i rëndësishëm regjistrimi i bisedës?

Risi është regjistrimi i gjithë bisedës së kontrollit vlerësues mjekësor. Vetëm nëse personi i siguruar me rastin e vlerësimit heq dorë nga regjistrimi i zërit, kjo nuk do të bëhet. Mirëpo, regjistrimi i bisedës mund të shkatërrohet deri në 10 ditë nga vlerësimi, nëse kjo kërkohet me shkrim.

Regjistrimi është i rëndësishëm, pasi kështu mund të mënjanohej kundërthëniet mes bisedës dhe vlerësimit të ekspertizës. Kjo mbron nga arbitrariteti dhe sqaron përplasjet përkitazi me ekspertizën vlerësuese. Regjistrimi zanor bëhet nga eksperti. Fillimi dhe fundi i intervistës, si dhe ndërprerjet e mundshme, duhet të vërtetohen nga personi i siguruar dhe eksperti. Kjo bëhet gojarisht me të dhënat e kohës kur kjo ka ndodh. Pas intervistës, regjistrimit zanor bashkë me ekspertizën vlerësuese do ti dërgohet të siguruarit.

### Çka ndodh me regjistrimin?

Regjistrimi mund të dëgjohet me rastin e procedurës në lidhje me sigurimin e invaliditetit (IV/AI) nga personi i siguruar, nga bartësit të sigurimit shqyrtues dhe nga autoritetet vendimmarrëse. Posa procedura, për të bërë regjistrimin zanorë, të jetë e plotfuqishme, sigurimi në pajtueshmëri me personin e siguruar guxon ta shkatërroj atë.



## Lajmërohuni për kursin e Movendo!

# Dija është fuqi!

A keni nevojë për dije specifike për përditshmërinë e juaj profesionale? Programi i Movendo edhe këtë vit ju ofron trajnime interesante. Si anëtar: e i/ e Unia çdo vit keni të drejtë të ndiqni së paku një kurs pa pagesë.

Marie Saulnier Bloch

Instituti arsimor e sindikatave të SGB/USS, ndër të cilat edhe Unia, ka si qëllim, të mbështesë punëmarrës:et mbi të drejtat dhe obligimet e tyre. Të 270 kurset, ndër to edhe uebinarë në internet, synojnë një thellim të njohurive në lëmin politike, ekonomike, të drejtën e punës dhe sigurimeve shoqërore, komunikim, bashkëpunim/formësim jetësor dhe instrumente pune. Oferta nuk është ekskluzive për sindikatave, por është i hapur edhe për të gjithë të interesuarit tjerë. Anëtar:et e sindikatave anëtare të SGB/USS ndjekin së paku një kurs pa pagesë.

Për nxitjen e barazisë, veçanërisht shanset e barabarta, disa oferta u dedikohen grupeve specifike, p.sh kurse për migrant:et, për gra, për njerëz të shtyrë në moshë dhe për të rinj. Së shpejti edhe në internet (online): fletëpalosje specifike me një listë të arsimimeve të rekomanduara, të cilat mund të jenë interesante për çdo person me sfond migracioni. Posaçërisht: sfidat politike në Zvicër, si mund të fuqizohet lëvizja sindikaliste në Zvicër, të drejtat në vendin e punës, natyralizimi, pensionet, sigurimet shoqërore, si mund të komunikohet më mirë, çka mund të bëhet në rast dyshimi të tregimit me qenie njerë-

zore... Ekipi redaktues i Horizonte ndër të tjera merre pjesë në shumicën e këtyre mundësive arsimore. Ne rekomandojmë veçanërisht arsimimet në gjermanisht dhe frëngjisht mbi politikën dhe të drejtën e migracionit, e cila i mundëson gjithsecilit, të jenë të informuar më mirë dhe të informojë kolegët dhe të njohurit e tyre më mirë! Të gjitha informacionet relevante i gjeni në ueb faqen [www.movendo.ch](http://www.movendo.ch).

Pasi, arsimimi më mirë domethënë, mundësim i përfaqësimit më të mirë i interesave!



Programi arsimor Movendo fuqizon avancimin e përfaqësimit të interesave

## Intervista



### Me «Progresso» deri tek profesionalizimi

Unia ka vite që angazhohet fuqishëm për arsimimin bazik Progresso. Ky trajnim është ideal për punonjësit pa profesion të mbaruar në gastronomi dhe ofrohet për lëmit e shërbimit, kuzhinës, mirëmbajtje shtëpiake dhe sistemin e gastronomisë. «Horizonte» për këtë ka biseduar me Mauro Moretto, përgjegjës i sektorit të gastronomisë në Unia.

### Ju personalisht angazhoheni fuqishëm për këtë trajnim, përse?

Në gastronominë zvicerane punojnë me dhjetëra mijëra njerëz pa arsimim të njohur. Progresso është arsimim fillestar i përsosur. Pjesëmarrësit për një kohë të shkurtër përfitojnë në profesionalizim dhe kështu kanë mundësi më të mira në përditshmërinë profesionale. Pos kësaj shërben si trampolinë për arsimime të mëtejme sikur është A-testi profesional (EBA).

### Çfarë roli luan Kontrata Kolektive Kombëtare e Punës (L-GAV/CCNT) në gastronomi tek këto trajnime?

Përmes kësaj, ne kemi mundësi që punonjëseve të ndërmarrjeve që i nënshtrohen KKKP u ofrojmë një seri trajnimesh e arsimimesh të mëtejme në të gjitha nivelet. Dhe këtë thuaja se me tarifë zero, deri në fund të vitit 2022, falë një ofensive arsimore, bile edhe falas. Përmes kësaj partnerët në gastronomi duan që punonjëseve tu ofrojnë perspektiva në këto kohë të vështira. Subvencionet financohen përmes kontributeve zbatuese të KKKP, në të cilat paguajnë ndërmarrjet dhe punonjësit. Për kontributin vjetor prej 89 frangave punonjësit mund të përfitojnë nga trajnim-arsimimi i mëtejme, i cili kushton me mijëra franga. Progresso, fjala bie ka koston e plotë prej 3450 frangave. Edhe ata që përkohësisht janë pa punë mundën me kushte të caktuara të ndjekin pa pagesë shkollimin e Progresso.

### Shumë punëdhënës hezitojnë, të dërgojnë punonjësit e tyre në këtë shkollim. Ata thonë «së pari mungojnë 5 javë, pastaj marrin 200 franga me shumë pagë minimale». Çka thoni për këtë?

Se kjo me të vërtetë ia vlen, pasi që të gjithë përfitojnë: punonjësit, ndërmarrja dhe mysafirët: Falë Progresso punonjësit janë më profesional dhe rritet edhe kualiteti e efikasiteti i punës së tyre. Dhe ata në kontaktin me mysafirë shesin ofertat më mirë çka kontribuon në shtimin e fitimit. Ndërmarrja përfiton nga trajnimi falas për punonjësit e tyre dhe nuk duhet të shqetësohet për asgjë – këto janë të gjitha përparësitë! Pos kësaj një arsimim mund të kontribuojë, që punonjësit ti mbesin më gjatë besnik ndërmarrjes. Edhe kjo është një faktor kostoje, pasi punonjësit e ri dhe përshtatja e tyre në punë ka një kosto të caktuar.

### Çka duhet të kenë parasysh punonjësit në bisedë me eprorët, nëse duan fjala bie të flasin për trajnimin në Progresso?

Për të planifikuar ndërmarrja, është shumë e rëndësishme, që dëshira për trajnim-arsimim të mëtejme të deponohet me kohë. Me këtë rast duhet vu në lojë përparësitë lartcekura. Jo së fundi, unë do të flisja për motivacionin përmes një trajnim-arsimim i tillë. Pasi shumë punëdhënës kanë drojë, që punonjësit pas përfundimit të trajnimit do të ndërrojnë ndërmarrjen. Kjo nuk duhet të jetë kështu, nëse ndërmarrja kujdeset për një veprimtari interesante me mundësi zhvillimi dhe karriere.

Më shumë informacione: [www.mein-progresso.ch](http://www.mein-progresso.ch)

sb/hil

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Sigurimi pensional: A mund ti kontrollojë kontributet në AP

Unë (30 vjeçar) në vitin 2020 kam punuar si shofer në një ndërmarrje logjistike. Gjithsejtë aty kam fituar 25 000 franga. Në llogarit e pagave unë shoh, se bëhen zbritje për AHV/AVS; IV/AI, EO/ APG dhe për një sigurim aksidental. Më duket e çuditshme që unë nuk shoh zbritjet për Arkën Pensionale (AP). Unë gjithashtu nuk kam marr asnjë librezë sigurimi pensional të AP. Mjerisht ndërmarrja nuk donë të më informojë. A mund të kontrolloi këtë personalisht?

**Regula Dick:** Po. Nga moshë 25 vjeç punëdhënësi juaj detyrueshëm duhet që të ju siguroi, posa të ardhurat tuaja të jenë më të larta se sa pragu hyrës në Arkën Pensionale Profesionale (në vitin 2020 ka qenë 21 330 franga). Arka pensionale dërgojnë çdo fillim viti certifikatën e pensionit. Në këtë certifikatë gjenden të dhënat mbi institucion ku jeni të siguruar dhe cilat kontribute janë paguar për ju. Pasi nuk keni marrë këtë certifikatë dhe në llogarinë e fletëpagesës suaj nuk duken kontributet tuaja në AP, punëdhënësi juaj si duket nuk ju ka siguruar fare, apo nuk iu është bashkëngjitur asnjë Arke pensionale. Për këtë janë përgjegjëse arkat e kompensimit të AHV/AVS-ë, që të kontrollojnë këtë. Drejtohuni tek arka e kompensimit të AHV/AVS të ish punëdhënësit tuaj dhe interesohuni mbi arën pensionale të ndërmarrjes, apo drejtohuni tek arka kantonale e kompensimit të AHV/AVS të Kantonit tuaj. Nëse punëdhënësi juaj nuk ka pajtuar asnjë arkë pensionale, arka e kompensimit do të urdhëroi një bashkëngjitime të detyrueshme tek Fondacioni grumbullues i Sigurimit Pensional Profesional. Ndërsa nëse punëdhënësi juaj ka një AP, por nuk ju ka lajmëruar ju dhe as pagën tuaj, njoftojeni AP mbi marrëdhënien tuaj të punës.

(Work, 19.11.2021)

### Arka e papunësisë: Sanksione shkakut i anulimit të patentës së vozitjes?

Unë punoi si shofer. Unë isha në festimin e ditëlindjes së shokut tim më të mirë, ku kam pirë pak si tepër dhe megjithatë kam ngarë vet automjetin për në shtëpi. Me këtë rast kam hasur në kontroll policore. Kështu mua më është marrë leja e vozitjes. Këtë e ka marrë vesh eprori im dhe më ka larguar nga puna. Arka e papunësisë në ndërkohë ka vendosur të mi shkurtojë 35 ditë kompensimi. A është kjo e saktë?



Despedido por conducir ebrio (Foto: Keystone)

**Markus Widmer:** Po, kjo është e saktë, pasi papunësia vlerësohet si faj i vet shkakuar. Vet shkakimi qëndron në lëndimin e obligimeve të detyrimeve të punës. Mirëpo edhe në rast se një person i siguruar përmes sjelljes ndryshe brenda apo jashtë ndërmarrjes i ka dhënë shkak punëdhënësit për shkakim. Kjo domethënë: Një person i siguruar merr në konsideratë, se sjellja e tij mund të ketë si pasojë largim nga puna. Pasi që ju si shofer, për të ushtruar profesionin tuaj, jeni i varur nga patenta e jua e shoferit, keni pasur parasysh se me humbjen e patentës suaj mund të humbni edhe vendin e punës. Në rast të vet shkakimit, arka e papunësisë duhet të dallojë mes vet shkakimit të lehtë, gjysmë të rëndë dhe atij të rëndë. Lartësia e shkurtimeve matet sipas shkallës së vet shkakimit. Një vet shkakim i rëndë gjobitet me 31 deri 60 ditë shkurtime. Kështu ju me të drejtë keni marrë 35 ditë shkurtime.

(Work, 3.12.2021)

### Shtatzënia: A duhet megjithatë që unë të bëjë orë të përperta?

Unë punoi si punëtorë magazine në degën ushqimore. Aktualisht kemi shumë punë, për çka ne duhet të bëjmë orë të përperta pune. Unë jam shtatzënë dhe nuk kam vullnet të bëj as përqindjen e punës sime. A duhet unë që të bëjë dhe orë të përperta pune?

**DAVID AEBY:** Jo. Rrethanat e pavolitshme të punës përmes nënës ndikojnë edhe tek fëmija dhe mund të disfavorizojë shëndetin dhe mirëqenien. Kjo ka të bëjë në një masë të caktuar edhe me organizimin e punës dhe strukturimin e orarit të punës. Ligji i punës përbën edhe një rregull gjegjësisë mbrojtës, i cila precizohet në urdhëresën përkatëse. Puna ditore duhet të kufizohet në kohën e rregullt të kontraktuar, pra në kontratën e punës dhe në përqindjen e caktuar. Shtatzënat dhe gratë gj-dhënëse nuk guxojnë të punojnë mbi orarin e kontraktuar para shtatzënisë. Pos kësaj vlen edhe ngarkimi maksimal me punë: Më shumë se 9 orë pune në ditë nuk guxojnë të punojnë gratë shtatzëna dhe gj-dhënëse. Nëse është kontraktuar një orar pune më i lartë ditore, atëherë ky duhet të reduktohet në maksimumin e 9 orëve. Edhe në situata të jashtëzakonshme nuk lejohet të kërkohet punë shtesë, e cila shkon përtej këtyre 9 orëve.

(Work, 21.1.2022)

# Ndryshimet në sigurimet shoqërore për vitin 2022

Këtu informoheni mbi risitë tek sigurimet e veçanta. Nuk janë të përkrahura në detaje të gjitha sigurimet.

Darinka Filipovic

## 1. AHV/AVS

Një rritje e re e pensioneve AHV/AVS do të rishikohet tek për vitin 2023, pasi këto pensione janë rritur së fundi me 1 janar 2021.

## IV/AI

Me 1 janar 2022 hyn në fuqi revidimi i 7-të i IV/AI. Fjala është për zhvillimin e mëtejshëm të integritetit të IV/AI, të krijimit të një sistemi pensionesh «pa përshkallëzim» dhe rregullim të njëjtë në lidhje me sqarimet dhe raportet e ekspertizave vlerësuese mjekësore për të gjitha sigurimet shoqërore (andaj kjo është për tu rregulluar në ATSG (Ligjin federal për pjesën e përgjithshme të ligjit të sigurimeve shoqërore): një revidim i vogël nga 1 janari 2022)

Të siguruarit, të cilëve do tu hiqet pensioni IV/AI, rishtas kanë të drejtë në 180 mëditje kompensim të jashtëzakonshme të sigurimit të papunësisë.

Rishtas zyrtarët e IV/AI informojnë personat mjekësorë mbi rezultatet dhe mbi hapat, të cilat janë paraparë apo janë pajtuar me pacientet: E njëjta vlen edhe për të kundërtën. Ky shkëmbim i të dhënave është ankoruar rishtas në ligj. Kështu Zyrtarët e IV/AI mund të kërkojnë e marrin vlerësimet të synuara mjekësore, se a priten rezultate shpresëdhënëse nga masat e planifikuara. Në anën tjetër, falë informacioneve të IV/AI, personat mjekësorë, janë më mirë në gjendje të mbështesin pacientet gjatë masave integruese.

## ATSG/LPGA

Nga 1 janari 2021 ka hyrë në fuqi revidimi i ATSG/LPGA (Ligji federal për pjesën e përgjithshme të ligjit të sigurimeve shoqërore). Në ndërlidhje me reformën e IV/AI nga 1 janari pasojnë ndryshime të tjera. Meqenëse këto rregullore janë gjithashtu të rëndësishme jashtë IV, ato janë zbatuar në ATSG/LPGA.

- Vendim i ndërmjetëm nëse i siguruarit dhe sigurimet shoqërore nuk bien dakord për ekspertin.
- Ekspertizat dy-disiplinore - gjithashtu vetëm entet dhe detyrat e miratuara të ekspertizave sipas parimit të rastësishëm
- Ekzaminuesit mjekësorë duhet të plotësojnë kërkesat federale.
- Regjistrimet zanore të intervistave dhe menaxhimi i skedarëve janë të detyrueshëm.
- Do mbahen listat e qasme për publikun në lidhje me caktimin e ekspertëve vlerësues.

## EL/PC

Nga 1 janari 2021 ka hyrë në fuqi reforma mbi përfitimet shtesë të AHV/IV AVS/AI. Për personat të cilët kanë marrë përfitime shtesë qysh para vitit 2021 kalimi në të drejtën e re vlen deri në fund të vitit 2023.

## 2. ALV/AC

Nga 1 qershori 2021 ka hyrë në fuqi reforma e vogël e ALV/ AC (sigurimit të papunësisë). Të papunët rishtas mund të lajmërohen online (përmes internetit) në RAV/ORP (Qendrën Rajonale për Ndërmjetësim pune).

# Kontributi i diasporës për fuqizimin e sindikatave në Kosovë

Aktivistët shqiptaro-zviceranë në kuadër të sindikatave dhe partive progresive kanë formuluar, aprovuar dhe adresuar pritjet e tyre ndaj Zvicrës dhe Kosovës. Sa i përket përfshirjes dhe mbështetjes së tyre për një zhvillim të qëndrueshëm dhe demokratik të Republikës së Kosovës. Për këtë çështje është aprovuar edhe një rezolutë nga migrantët socialdemokratë dhe Partia Socialdemokrate e Zvicrës.

Sa i përket botës së punës, në pikën 5 të rezolutës thuhet: Ne presim nga të gjithë aktorët politik e shoqëror që përmes mbështetjes dhe përfshirjes së diasporës të kontribuojnë për ndërtimin e sindikatave të pavarura dhe të fuqishme. Vetëm me sindikata të forta dhe shoqata të punëdhënësve të afta për të negociuar, partnerët socialë mund të negociojnë dhe zbatojnë zgjidhje të qëndrueshme e të



Zyra për Ndërmjetësim Pune në komunën e banimit është anuluar, tani përgjegjësi vetëm janë entet e përcaktuara zyrtare nga Kantoni (zakonisht të njohura me shkurtesën RAV/ORP). Është krijuar platforma e qasjes ALVIsV (Urdhëresa e sistemit informativ) për shërbimet elektronike si dhe një publike për Ndërmjetësim Pune.

Është sqaruar edhe terminologjia: Seco (Sekretariati Shtetëror për Ekonomi) drejton zyrën e kompensimit të ALV/AC. Zyra e kompensimit është përgjegjëse për zbatimin e ALV/AC. Termi Seco në ligj do të zëvendësohet me ALV/AC.

Përpos përshtatjeve të ndërlidhura me koronën, asnjë risi nuk është raportuar për vitin 2022.

## 3. BVG/LPP

Për vitin 2022 nuk janë raportuar risi. Norma minimale e interesit për aktivet e pensionit të të siguruarve aktivë është lënë në 1%. Për fonde të caktuara pensioni, norma e konvertimit përshtatet me situatën.

## 4. UV/AA

Nga 1 janar 2022, Suva (Institucioni i sigurimit aksidental të Zvicrës) do të ketë një zyrë të re (të pestë), sigurimin e aksidenteve për personat që i nënshtrohen masave rehabilituese të IV/AI.

## 5. FamZ/LAFam

Sa i përket shtesave familjare, nuk janë paralajmëruar ndryshime sistematike. Në disa kantone, tarifatat për shtesat e fëmijëve dhe të trajnimit ka të ngjarë të rriten. «Llojet dhe qasjet ndaj shtesave familjare» do të prezantohen nga BSV/OFAS (Enti Federal për Sigurimet Shoqërore) në fund të vitit 2022.

përgjithshme (kontrata kolektive të punës, marrëveshjet kolektive). Këto krijojnë bazamentin për paga të mira dhe të drejta dhe kushte të mira dhe të sigurta të punës si dhe zhvillimin e një sistemi të fortë të aftësisë profesionale. Pos tjerash ne presim që qeveria e Kosovës të futë pagën minimale, premtim ky i saj në fushatën zgjedhore.

Një grupi i përbashkët punues gjatë pjesës së parë të këtij viti do të vizitojë Kosovën, ku ndër të tjera do të sqarojë mundësitë e kontrikutit edhe në botën e punës në Kosovë.

Për më shumë shih edhe: [pointegra.ch/diaspora-me-pritshmeri-konkrete-karshi-zvicres-dhe-kosoves/](http://pointegra.ch/diaspora-me-pritshmeri-konkrete-karshi-zvicres-dhe-kosoves/)